

URDHËR
Nr. 889, datë 29.10.2024

PËR DELEGIMIN DHE DISA RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË
MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Sekretarit të Përgjithshëm, si vijon:

a) Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në proceset gjyqësore kur thirret si palë në gjykim, nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë.

b) Nënshkrimi i akteve procedurale, si: kërkesëpadi, prapësime, deklarata mbrojtjeje, parashtrime, ankime, rekurse etj., bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Përrjashtëmish, paraqitja e kërkesave të tjera, si dhe çdo veprim procedural i nevojshëm gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore mund të bëhet edhe nga përfaqësuesit me autorizim, me shkrim dhe/ose me gojë.

2. Përfaqësimi për proceset gjyqësore bëhet si rregull nga juristë të Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe/ose specialistë të fushës për të cilën është ngritur kërkesëpadia. Rast pas rasti, përfaqësimi gjyqësor mund të bëhet edhe nga nëpunës të tjerë të institucioneve të varësisë dhe/ose degëve të tyre territoriale.

3. Të gjitha strukturat e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit detyrohen të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm, mbajtjen e një qëndrimi zyrtar me shkrim dhe/ose dhënie mendimi teknik, me qëllim realizimin e mbrojtjes ligjore nga ana e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

4. Drejtoria e Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme merr masa për sigurimin e logjistikës së nevojshme dhe lëshimin e autorizimeve përkatëse ndaj juristëve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, në varësi të seancave gjyqësore të caktuara dhe rëndësisë që paraqet procesi gjyqësor.

5. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si dhe me pushimin e organit delegues ose të deleguar.

6. Urdhri nr. 687, datë 12.9.2024, “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen të gjitha strukturat e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si edhe institucionet e varësisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja